



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I MBROJTJES SË KONSUMATORËVE**

---

**VENDIM**

**Nr.19, Datë 22.02.2012**

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve me pjesëmarrjen e:

- Znj. Anila Jani                      Kryetar
- Z. Gerdjan Xhanari                Nënkyetar
- Znj. Marsida Xhaferllari        Anëtar
- Z. Altin Goxhaj                    Anëtar
- Z. Zamir Mocka (Stefani)        Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 22.02.2012, vazhdoi shqyrtimin e ankesës së ardhur nga Esmeralda Elezaj, ish-studente e Universitetit Jo Publik “Vitrina”, në lidhje me praktiken e çregjistrimit që ndiqet nga ky Universitet.

Komisioni pas shqyrtimit të ankesës së sipërpërmendur,

**VËREN SE:**

Shqyrtimi i kësaj ankese ka filluar në mbledhjen e datës 7.11.2011 dhe për një vlerësim të plote të kësaj çështjeje Komisioni i ka kërkuar Universitetit Vitrina informacione në lidhje me problematiken e ngritur, nëpërmjet shkresës me datë 14.11.2011, nr. prot.31/1 dhe ritheksuar përsëri, me shkresën e datës 25.01.2012, me anë të së cilës, Universiteti Jo Publik Vitrina, është ftuar edhe në seancën dëgjimore të datës 27.01.2012. Në seancën dëgjimore të datës 27.01.2012, përfaqësuesja ligjore e Universitetit Vitrina deklaroi se nuk është e autorizuar të japë sqarime apo informacione.

Komisioni me shkresë nr. prot 42/2, datë 30.01.2012 i bën me dije marrjen e Vendimit nr.18, datë 27.01.2012, nëpërmjet të cilit Universiteti Vitrina gjohet, me shumën prej 300,000 leke, për mosdhënie informacioni, si dhe i kërkohet lista e studentëve që janë çregjistruar për vitin akademik 2010-2011, gjithashtu edhe një kopje e kontratës tip të Universitetit me studentet.

Komisioni konstaton se, në vijim të Vendimit nr.18, datë 27.01.2012 dhe shkresës nr. prot 42/2, datë 30.01.2012, Universiteti Vitrina ka kryer shkelje të përsëritur të nenit 52/1 të ligjit nr.9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar, sipas të cilit:

*“Tregtaret janë te detyruar te japin ne mënyre te qarte, te vërtete dhe jo te mangët, të gjithë informacionin e kërkuar nga organet zbatuese dhe struktura përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorëve, sipas dispozitave te këtij ligji”*

Sipas pikës 4 te nenit 57 te ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve:

*“Ne rast përsëritje, gjobat e parashikuara ne këtë nen dyfishohen. Përsëritje vlerësohet rasti, kur shkelësi kryen te njëjtën shkelje për here te dyte, brenda një periudhe prej 5 vjetësh”*

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve mbështetur ne nenin 52/1; shkronjën “d”, pika 2, neni 57; pikën 4 te nenit 57 te Ligjit nr. 9902, date 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar, si dhe ne shkronjën “c”, pika 6 të VKM nr. 1444, datë 22.10.2008 “Për mënyrën e funksionimit e te pagesës se anëtareve te komisionit te mbrojtjes se konsumatorëve, si dhe përcaktimin e procedurave te vlerësimit te shkeljeve”.

#### **VENDOSI:**

1. Universiteti Vitrina, te gjobitet ne masën 600 000 leke.
2. Universiteti Vitrina, te njoftoje menjëherë Komisionin e Mbrojtjes se Konsumatorëve, për pagesën e gjobës, brenda 15 ditësh nga marrja e njoftimit te këtij Vendimi.

Kundër Vendimit te Komisionit te Mbrojtjes se Konsumatorit keni te drejte te ankoheni në Gjykatë brenda 30 ditëve nga data e marrjes dijeni për vendimin.

**KRYETAR I KOMISIONIT**

